

Abstrakt

Paraburgimi është i nevojshëm për t'i dhënë prokurorisë mundësinë për të marrë informacion në fillim të hetimit, kur është e pamundur të mbahen sekrete marrëveshjet ndërmjet të akuzuarit dhe/ose kur është e arsyeshme të parashikohet që i akuzuari mund të arratiset. Paraburgimi është masa më e rëndë me anë të së cilës sigurohet prania e të pandehurit në procedurë penale. Aplikimi i kësaj mase krijon kushte, hap rrugën për ndërmarrjen e veprimeve procedurale nga organet e ndjekjes dhe organet gjyqësore. Qëllimi i këtij punimi është që të paraqesim kriteret për paraburgim dhe analizën e procedurave për caktimin e paraburgimit. Në punim është paraqitur edhe një krahasim të sistemeve të paraburgimit në mes të shteteve të ndryshme të Ballkanit Perëndimor, duke ofruar kështu ngjashmëritë dhe dallimet në mes të sistemeve të këtyre shteteve. Metodologjia e punimit është përshkruese, hulumtuese, krahasimore dhe juridike. Metodologjia përshkruese është zbatuar në hulumtimin dhe përshkrimin e materialeve teorike, kryesisht nga publikimet shkencore relevante me analizën apo temën e hulumtimit, libra të fushës përkatëse si dhe materiale relevante nga burime kredibile të informacionit. Në anën tjetër metodologjia hulumtuese është zbatuar në analizën dhe paraqitjen e të dhënave fillimisht dytësore. Të dhënat janë mbledhur në lidhje me numrin e personave të paraburgosur, duke përfshirë edhe të dhënat personale të tyre, ku janë paraqitur krahasime të ndryshme sipas (gjinisë, grupmoshës, statusit social dhe nivelit të arsimit). Të dhënat fillimisht janë grumbulluar në programin Excel, duke krijuar kështu databazën e studimit, më pastaj të dhënat janë kontrolluar dhe filtruar. Ndërkaq që për paraqitjen e rezultateve dhe analizave të tjera të nevojshme është përdorur programi i specializuar në statistika – SPSS. Metodologjia krahasimore është përdorur në krahasimin e sistemeve penale për caktimin e paraburgimit në vendet e Ballkanit Perëndimor, duke paraqitur dallimet dhe ngjashmëritë në mes të sistemeve në këto shtete. Nga rezultatet e paraqitura në këtë punim konkludojmë se në vitin 2019 ka pasur më së shumti raste të caktimit të masës së paraburgimit, ndërkaq në vitin 2020 ka pasur më së paku raste. Në total, në katër vitet e hulumtimit kemi gjithsej 160 raste të caktimit të masës së paraburgimit dhe 16 raste të refuzimit. Gjetjet tregojnë se kemi trend linear negativ, i cili nënkupton se nga viti 2017 deri në vitin 2020 në përgjithësi kemi trende rënëse të paraburgimit.

Fjalët kyçe: Paraburgim, Prokuror, Masa, Kriter, Hetim.